

Academy for Training and Technical Assistance, Autostrada Biennale, DokuFest, EC Ma Ndryshe, Fondacioni Legatum, Fondacioni Lombardhi, Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Institute for Sustainable Development of Youth, Instituti Demokratik i Kosovës, Organizata e Personave me Distrofi Muskulare, X40 – 40 Bunar, OJQ THY

PËR Deputetët/et e Kuvendit të Kosovës nga Prizreni
Anton Çuni, Duda Balje, Emilija Redzeqi, Fikrim Damka, Hatim Baxhaku, Kujtim Paçaku, Mufera Sinik, Mytaher Haskuka, Nait Hasani, Nezir Çoçaj, Zafir Berisha

NGA Grupi i organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në Prizren

DATË 17 qershor 2016, Prishtinë

KËRKESË PËR DEPUTETËT E KUVENDIT TË KOSOVËS NGA PRIZRENI
Debat parlamentar për të kërkuar përgjegjësi për tragjedinë e Prizrenit

Të nderuar/a deputetë/a

Nga ju kërkojmë që të merrni nismën brenda Kuvendit të Kosovës për të përfshirë në rendin e ditës së seancës së ardhshme parlamentare rastin e tre vjeçares Xheneta Gashi, e cila humbi jetën javën e kaluar në Prizren. Kërkojmë që Kuvendi i Kosovës, konform mandatit që ka, të ftojë qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera në përgjegjësi për këtë tragjedi.

Ne si organizata të shoqërisë civile kemi publikuar qëndrimin tonë dhe po angazhohemi për të kërkuar llogari nga institucionet lokale dhe qendrore për vdekjen e tre vjeçares Xheneta Gashi. Ne i kemi dy kërkesa: dorëheqjen e Kryetarit të Komunes së Prizrenit dhe dy ministrave të qeverisë së Kosovës, atij të kulturës dhe atij të planifikimit hapësinor, si dhe ndjekjen penale të të gjithë përgjegjësve institucional që me mosveprimin e tyre shkaktuan tragjedinë.

Ne kërkojmë që rasti i neglizhencës institucionale që prodhoi tragjedinë e javës së kaluar të diskutohet si pikë e veçantë e rendit të ditës në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës. Për këtë, ju ftojmë që sa më parë të merrni këtë nismë për debat parlamentar për tragjedinë e Prizrenit.

Në emër të grupit të organizatave,
Hajrulla Çeku
EC Ma Ndryshe